



Në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023), si dhe në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë, Agjencia e Kosovës për Akreditim shpall:

## KONKURS

### Për anëtar të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

#### 1. Dy (2) anëtarë juristë me profesion.

**2.Kohëzgjatja e angazhimit:** Anëtarët zgjidhen për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.

#### Kualifikimi dhe përshtatshmëria profesionale

Një kandidat për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 23 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

**Kandidati nuk kualifikohet si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, nëse:**

- Aktualisht është zyrtar ose menaxher në një institucioni të arsimit të lartë në Kosovë;
- Aktualisht është nëpunës i shërbimit civil;
- Aktualisht është i angazhuar në ndonjë subjekt politik në Kosovë, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesit që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

## Kompensimi

Kompensimi i anëtareve të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim bëhet në bazë të nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) si dhe në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë.

## Procedura e konkurrimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Dokumentin e identifikimi (kopje të dokumentit identifikues: pasaportës, letërnjoftimit apo certifikatës së shtetësisë, e cila duhet të jetë valide).
- Certifikatën mbi gjendjen penale të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës. (certifikata e nxjerrë online në platformën *e-Kosova* do të pranohen);
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (Dëshmitë: Diplomën e kualifikimit profesional të Fakultetit Juridik).
- Vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni kompetent përgjegjës - zyra e personelit ku specifikohet data e fillimit dhe data e mbarimit të marrëdhënies së punës.
- Pasqyrat e kontributeve pensionale-Trusti Pensional, ky kriter nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion;
- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI ose të këtë dëshmi që është në proces të nostrifikimit);

Aplikimi bëhet online nëpërmes E-Mail: [Besim.Jonuzaj@rks-gov.net](mailto:Besim.Jonuzaj@rks-gov.net), me përshkrimin në Subject:  
Aplikim për anëtar të Komisionit të Ankesave.

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë **nga data 01 shkurt 2024 deri me datën 15 shkurt 2024, ora 16:00.**

Agjencia e Kosovës për Akreditim inkurajon të gjithë të interesuarit dhe mirëpret aplikimet e secilit kandidatë për tu bërë pjesë e Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).